



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 812 / Prot. 5

Vlorë, më 25.03.2025

VENDIM

Nr. 23 , datë 03. 03. 2025

PËR

"KRYERJEN E PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT BRENDA AFATEVE LIGJORE, MËNYRËN E KRYERJES SË KËSAJ PAGESE, SHLYERJEN E DETYRIMEVE NGA ANA E STUDENTËVE TË CIKLIT TË I-rë, TË II-të DHE TË III-të TË STUDIMEVE, TË CILËT REZULTOJNË DEBITOR"

Bazuar në nenin 38, nenin 98, pika 2, të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 73, pika 2, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, Rregulloren e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, Vendimit Nr. 52, datë 19.11.2020 të Bordit të Administrimit, Vendimit Nr. 3, datë 07.01.2022 të Bordit të Administrimit, nw mbledhjen e datës 03.03.2025 Senati Akademik,

VENDOSI:

- 1) Kryerjen e pagesës vjetore të "Tarifës së Studimeve" brenda afateve ligjore të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjithë studentët si më posht:
 - 1/a Studentët që ndjekin Ciklin e I-rë të studimeve, në programin e I-rë të studimeve, pagesa e "Tarifës Vjetore" duhet të kryhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik (sipas Vendimit Nr. 52, datë 19.11.2020 të B.A.).
 - 1/b Studentët që ndjekin Ciklin e I-rë të studimeve në programin e II-të të studimeve, pagesa e tarifës do të kryhet në dy këste (sipas Vendimit Nr. 52, datë 19.11.2020 të B.A.), në këtë mënyrë:
 - Kësti i I-rë, duhet të paguhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit akademik
 - Kësti i II-të duhet të paguhet brenda 30 ditëve nga fillimi i semestrit të II-të.
 - 1/c Studentët që ndjekin Ciklin e II-të të studimeve, në Programin e I-rë dhe të II-të të Studimeve, pagesa do të kryhet në katër këste (sipas Vendimit Nr. 52, datë 19.11.2020 të B.A.), në këtë mënyrë:
 - Kësti i I-rë, duhet të paguhet brenda 30 ditëve nga fillimi i Vitit Akademik.
 - Kësti i II-të, duhet të paguhet para sezonit të provimeve të semestrit të I-rë.
 - Kësti i III-të, duhet të paguhet para sezonit të provimeve të semestrit të II-të.
 - Kësti i IV-të duhet të paguhet para procesit të diplomimit për Vitin e II-të dhe brenda muajit Shtator për Vitin e I-rë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- 2) Kryerjen e pagesës së "Tarifës së Studimeve" përpara sezonit të provimeve, për të gjithë studentët që ndjekin një program studimi në UV, të cilët nuk kanë kryer pagesën vjetore të shkollimit në afatin kohor të përcaktuar.
- 2/a Zyrat e Studentit pranë çdo fakulteti, të evidentojnë mospagesën e tarifës nga ana e studentëve dhe të pregatisin listat e studenteve debitor sipas degëve përkatëse dhe t'ia percjellin këtë listë Sektorit të IT-së në UV si edhe sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse konform nenit 7 të Rregullores së UV-së *(nëpërmjet postës elektronike zyrtare)*.
- 2/b Pezullimin e aksesit në "Sistemin UVMS" të të gjithë studentëve të cilët rezultojnë debitor sipas listave të percjella nga Zyrat e Studentëve, deri në shlyerjen e detyrimeve.
- 2/c Zyrat e Studentit pranë çdo fakulteti, të percjellin pranë drejtuesit të Njesisë Bazë, listën e studentëve debitorë të evidentuar. Drejtuesi i Njesisë Bazë i percjell menjëherë listën e debitorëve (në mënyrë elektronike me e-mail) pedagogut të lëndës i cili nuk duhet të lejojë që studenti/studentët që nuk kanë shlyer detyrimet përkatëse, të hyjnë në provim.
- 2/d Zyrat e Studentit pranë çdo fakulteti të monitorojnë para fillimit të çdo provimi dhe të raportojnë te Zv.Rektori Akademik mbi zbatimin e pikës 2/c.
- 3) Sekretariteti mësimor përpara procesit të diplomimit, të hartojnë listën e studentëve që diplomohen dhe t'ia percjellin Zyrate të Studentit të cilat duhet të konfirmojnë faktin nëse studenti që do të diplomohet i ka shlyer të gjitha detyrimet për të gjitha vitet akademike *(tarifa e studimit)* ndaj UV-së.
- 3/a Zyrat e Studentit, të konfirmojnë shlyerjen e pagesës së tarifës së shkollimit për të gjitha vitet akademike, për studentët të cilët do të diplomohen, duke i dorëzuar sekretarive mësimore dokumentacionin vërtetues *(të gjitha faturat origjinale të pagesës së tarifës së shkollimit)*.
- 3/b Sekretariteti mësimor të administrojnë dokumentacionin *(faturat origjinale të pagesës së tarifës së shkollimit)* e percjellë nga Zyrat e Studentit dhe këtë dokumentacion t'a bëjë pjesë të dosjes së studentit.
- 4) Studentët doktorantë që ndjekin Ciklin e III-të të studimeve, të kryejnë pagesën në fillim të çdo semestri për vitin akademik respektiv *(sipas afateve të përcaktuara në Vendimin Nr. 3, datë 07.01.2022 të B.A.)*.
- 4/a Sekretariteti mësimor të pezullojnë shërbimin për të gjithë studentët doktorantë të cilët rezultojnë debitor, deri në shlyerjen e detyrimeve.
- 4/b Studentët që nuk shlyejnë këto detyrime nuk lejohen që të vazhdojnë programin e planifikuar të doktoraturës për vitin pasardhës.
- 5) Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, Zyrat e Studentëve, Sekretariteti Mësimor pranë çdo fakulteti, Sektori IT-së pranë UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- 6) Sekretaritë mësimore, të bëjnë afishimin e këtij Vendimi në ambjentet e çdo fakulteti si dhe pranë Zyrave të Studentit.
- 7) Një kopje e këtij Vendimi, të përcillet për njohje Administratorit të UV-së.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
PROF. DR. AURELA SALIAJ

